



REPUBIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVO

KOMUNA E KLINËS
MUNICIPALITY OF KLINA
OPŠTINA KLINA



www.komuna-kline.org

Komuna e Klinës

Kuvendi i Komunës

01Nr. 06-25297 2025

Klinë, 11, 08, 2025

PROCESVERBAL

Nga mbledhja e Kuvendit të Komunës së Klinës, mbajtur me datë 27. 06. 2025, në sallën e Kuvendit, nisur nga ora 10:00.

Mbledhjen e hapi kryesuesi I Kuvendit, z. Fadil Gashi I cili përshëndeti kryetarin e Komunës , anëtarët e kuvendit dhe gjithë të pranishmit në sallë. Kryesuesi konstatoi se kuvendi mund të vazhdoj punimet pasi që është kuorumi I duhur.

Sa I përket Rendit të Ditës, kryesuesi tha se ka disa propozime. Në pikën 4 te rendit të kaloj Shqyrtimi I raportit nga konsultimet publike, raport për KAB. Dhe ka propozim nga nënkryetarja që pikën 8 ta zhvendosim në një seancë tjetër.

Nënkryetarja e komunës, znj. Marqe Selmanaj sqaroj kërkesën që të zhvendoset kjo pikë për seancën tjetër bazuar në rekomandimin nga koordinatori për performancë.

Po ashtu kryesuesi tha se është edhe kërkesa për informatë lidhur me mbeturinat në territorin e Komunës së Klinës nuk mund ta realizojmë pasi që nuk është prezent drejtori I njësisë.

Hapet diskutim

Znj. Valmira Krasniqi: Përshëndetje të gjithëve. Propozoj që në këtë seancë të shtohet si pikë e rendit të ditës : Lirimi nga pagesa për shërbimet që ofrohen në QKMF për Zjarrfikësit dhe Policinë. Ky do të ishte një akt simbolik mirënjohjeje për punën e tyre.

Kryesuesi tha se është një rregullore e miratuar që nuk mund të ndryshohet. Është rregullore në fuqi për tarifat. Që ta realizojmë këtë duhet të ndryshohet rregullorja në fuqi.

Znj. Valmira Krasniqi tha se kemi të drejt pasi që edhe komuna e Istogut e ka bërë një gjë të tillë.

z. Tunë Dedaj: Përshëndetje. Shumë më mirë është që të ju rriten pagat zjarrëfiksive dhe policisë se sa të ndërhyhet në rregullore. Ka shumë kategori njerëzish që nuk marrin asnjë lloj page më mirë do të ishte që ata të lirohen nga pagesat.

Lidhje me këtë temë u diskutua tutje nga Valmira Krasniqi, Fadil Gashi, kryesues, Valmir Bacaj etj. Ky I fundit tha se ata për të cilët kemi menduar që të lirohen nga pagesat ne kemi bërë propozimet dhe janë futur në rregullore. Ndërsa z. Zafer Gashi pyeti se a mund të vijë në seancën tjetër edhe raporti I auditorit të përgjithshëm. Dhe a do të ketë diskutim pas raportit të kryetarit.

Kryesuesi sqaroi se raporti i kryetarit vetëm shqyrtohet por nuk votohet, njëjtë sikurse raporti i auditorit të përgjithshëm.

Kryesuesi i vuri në votim tre propozimet e bëra për rendin e ditës dhe me 23 vota për u miratua

Propozimi i znj. Valmira Krasniqi pas vendosjes në votim morri 2 vota për dhe 3 abstenime prandaj nuk kaloi.

Pika 1 e Rendit të Ditës: Arsyetimi i mungesave

Kryesuesi tha se ka konfirmim për mungesë me arsye për Kushtrim Halitin, Asdren Ramadani, Florentina Berisha ndërsa Blerta Gashi vonohet pak.

Pika 2 e Rendit të Ditës: Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.

Procesverbali u miratua me 23 vota për, asnjë kundër dhe asnjë abstenim U MIRATUA

Pika 3 e Rendit të Ditës: Shqyrtimi dhe miratimi i rekomandimeve të KPF-së.

Kryesuesi tha se pikat që janë në rend të ditës nuk aknë nevojë që të shqyrtohen.

z. Esat Raci: Përshëndetje. Kërkesat për Shefqet Deskaj dhe Aferdita Binakaj për shërim, do të doja të dija se sa ka mundësi buxhetore ekzekutivi. A mund të marrim vendim nëse si kuvend që të rritet shuma, ka pasur raste më herët kur e kemi bërë.

Kryesuesi tha se e vetmja mundësi është kjo shumë simbolike nga ekzekutivi që është 400 euro. Më përpara kemi vendosur nëse por tanimë na është kërkuar që këto kërkesa të realizohen nga ekzekutivi ndryshe vendimet e kuvendit për këtë natyrë do të kthehen nga ministria.

z. Tunë Dedaj: Tek rasti i Shefqetit, unë e kam njohur shumë mirë. Është në gjendje shumë të keqe ekonomike. Është mirë të bëhet një ndryshim dhe të i ndihmohet. Nëse ka mundësi ky kuvend që të i ndaj mjete.

z. Fadil Gashi, kryesues: Sa mora informim nga shefi i kabinetit, ka dy vjet që ndihmohet me shumën 499 euro nga zyra e kryetarit. Nëse ju pajtoheni le të jetë një rekomandim për zyrën e kryetarit, kur të bëhet ndërtimi i buxhetit të bëhet një fond për këso raste. Nëse ju duhet vendimi i kuvendit që të rritet shuma nga zyra e kryetarit në jemi gati në çdo seancë që të marrim vendim, por nuk jam ihtar që të merret vendim dhe të mbetet vetëm në letër.

Me 24 vota për asnjë kundër dhe asnjë abstenim U MIRATUAN rekomandimet

Pika 4 e Rendit të Ditës: Shqyrtimi i raportit nga procesi i konsultimit publik për kornizën afatmesme buxhetore 2026-2028

z. Enver Berisha, drejtor i FEZH: Përshëndetje të gjithëve. Fillimisht ne kemi startuar me dëgjimet buxhetore me kryetarët e BL. Pastaj kemi vazhduar me dëgjimet buxhetore nëpër të gjitha bashkësitë lokale. Ka qenë një prezencë solide, janë bërë debate, janë propozuar shumë kërkesa. Nga 136 kërkesave të dala nga dëgjimet buxhetore, 122 janë pranuar dhe janë futurë në këtë kornizë buxhetore afatmesme. Edhe këtë vit sikurse vitin e kaluar dëgjimi direkt nëpër fshatra ka dhënë efekt. Mbi 80% e projekteve të realizuara vitin e kaluar kanë qenë të propozuara nga dëgjimet nëpër bashkësi lokale.

Materiali është i gjerë dhe ndoshta nuk është e nevojshme që të prezantohet komplet pasi që ju veç e keni.

z. Esat Raci: Ju përgëzoj për dëgjimet që i keni bërë me qytetarët. Është vit zgjedhor dhe mendoj dhe shpresoj që punët jo të mira që i keni bërë të i shohin qytetarët. Edhe politikat e punësimit që tash konkurset i aknë të hapura në administratë dhe QKMF, qytetarët do të bëjnë ndryshime. Nuk do të jua lejoj që ju ta realizoni këtë kornizë afatmesme buxhetore.

Pika 5 e Rendit të Ditës: Shqyrtimi dhe miratimi i draft kornizës afatmesme buxhetore 2025-2028

z. Enver Berisha, drejtor i FEZH: Sa i përket dëgjimeve buxhetore dhe kësaj draft kornize buxhetore të dyja janë të rregulluara me rregullore dhe ligj. Dua të i them Esatit se bazën e kësaj kornize e marrim nga niveli qendror dhe ne e përshtatim sipas kërkesave që mendojmë se janë të domosdoshme. Ky projekt buxhet formohet nga grandit qeveritar dhe të hyrat vetanake që këto të hyra i kemi tejkaluara çdo vit.

Drejtori i financave, z. Berisha foli për ndarjen e buxhetit nëpër kategori të caktuara. Ai foli me shifra dhe detaje.

Kryesuesi tha se nëse duam të bëhemi objektiv, përformancën e komunës e shton më së shumti Kuvendi.

Znj. Valmira Krasniqi: Sa i përket kësaj kornize ne si LVV e kemi analizuar dhe nuk e mbështesim pasi që nuk përfaqëson nevojat reale të qytetarëve tanë. Projektet që ne i kemi propozuar vazhdimisht nuk janë përfshi në këtë kornizë. Kemi kërkuar ndërtimin e çerdheve, përkrahjen e nënave vetushqyese por nuk janë marrë për bazë. Për 8 vjet ky kryetar nuk ka arritur të siguroj as ujin e pijshëm. Kjo kornizë buxhetore është dëshmi e një qeverisjeje të shkëputur nga realiteti dhe interesave të qytetarëve. Nuk mund ta përkrahim një plan që injoron, rinin e qytetit tonë, gratë e komunës etj. prandaj nuk do ta votojmë pro.

z. Qemajl Sejdiu, drejtor i DKA: Përshëndetje. Pasi që asamblistja i përmendi çerdhet, është një çerdhe e nisur nga ministria e arsimit dhe në fakt ju nuk keni bërë asgjë. Kur ka ardhë kryeministri do të ishte mirë ta dërgoni atje që ta vizitoj. Komuna e Klinës e ka fituar edhe një çerdhe 1.5 milion euro. Dëshiroj me ta kujtuar që qeveria do të ishte mirë që ta përfundoj çerdhen e nisur e jo të i detyroj qytetarët të paguajnë nga 130 euro nëpër çerdhe private.

Znj. Valmira Krasniqi: Drejtor që 8 vjet qeverisje dhe tani e gjetet të bëni planin ta ndërtoni një çerdhe? Ju keni premtuar çerdhe. Në lagjen Arbëria ka qenë e nevojshme që të ndërtohet një çerdhe e besa edhe një shkollë aty.

z. Qemajl Sejdiu, drejtor i DKA: Në takimet që zhvillojmë me ministrinë e arsimit e kam ngrit zërin vazhdimisht që të vijnë të intervenojnë. Është projekt i ministrisë së arsimit i nisur në 2009 dhe ka mbetur ashtu, prandaj po them se është më e moralshme që të përfundoj ajo çerdhe e nisur e pastaj të bëhet politikë këtua.

z. Valmir Bacaj: Ne e kemi lexuar raportin e dëgjimeve publike për kornizën buxhetore dhe nuk kam lexuar që opozita, LVV konkretisht të ketë bërë ndonjë propozim. Sa i përket çerdheve që po përmenden nuk është risi dështimi i qeverisë të dështoj. Qeveria ka premtuar qëndra çerdhe e i ka ndërtuar vetëm një apo 4 apo 5. Sa i përket ujit të pijshëm, nuk e diji pse ka marr pjesë kryeministri në përrurim të fundërruesit pasi që qeveria nuk ka investuar asnjë cent në atë projekt. Kështu që ne jemi

pro miratimit në parim të kësaj kornize sepse konsiderojmë që është vazhdimësi e qeverisjes së mirë të kryetarit Zenun Elezaj.

z. Enver Gashi: Përshëndetje. Sa I përket projekteve në këtë kornizë afatmesme buxhetore I përkrahim të gjitha. Duke I shikuar prioritete dhe nevojat e shumta të qytetarëve dua të ndalem tek bashkësia më e madhe lokale ajo e Sferkës. Projektit të ndërtimit të infrastrukturës nëntokësore dhe mbitokësore Sferkë- Volljak- Dush -Qupevë kërkoj që të I shtohet vlera. Po ashtu edhe zgjerimi I parkut të Sferkës. Edhe një gjë tjetër tek kjo kornizë; ndërtimi I infrastrukturës nëntokësore dhe mbitokësore shkruan Volljak-Sferkë-Qupevë-Dush. Është më mirë të shkruhet Sferkë- Volljak-Qupevë-Dush pasi që Sferka është bashkësi më e madhe.

z. Enver Berisha, drejtor I urbanizimit: Përshëndetje. Mendoj që ka të drejt Enver Gashi, kjo mund të ndryshoj si radhitje emrash.

z. Enver Berisha, drejtor I FEZH: Dua t'i përgjigjem asamblistes së LVV. Asamblistët e dinë qe derisa të aprovohet kjo kornizë buxhetore gjithkush ka të drejt të bëjë propozime. Më mirë është që të sjellën propozime se sa të debatohet. Sa I përket çerdhes që ka pasur të ndërtohet në lagjen "Arbëria" , është ndryshuar lokacioni dhe çerdhja do të ndërtohet tek shkolla "Motrat Qiriazit"

z. Zafer Gashi: Ne e kemi thënë qëndrimin tonë si subjekt. Ajo që e tha Valmira dhe Esati nuk pritet që kjo kornizë buxhetore të zbatohet nga kjo qeveri e dështuar. Për Sferkën, nuk janë kryer projektet. Drejtori I arsimit e ka përmendur disa herë se ajo çerdhe në Zajm duket keq, e vërtetë qe duket keq, dhe sipas mendimit tim personal nuk I plotëson kushtet për të qenë Çerdhe sepse aty kemi vërshime te lumit dhe rruga është shumë afër çerdhes. Për ujën, shumë e vërtetë është qe ka investuar edhe qeveria, edhe komuna edhe Hidrodrini. Ajo që ka ndodhë është një mashtrim I qytetarëve. Fton kryeministrin dhe thotë se presim edhe disa ditë të kryhen punimet dhe [pastaj të vihet në punë. Nuk është I përfunduar projekti , filtrat e vendosur aty nuk janë në funksion. Ka kaluar koha kur kemi shit fjalë për fushatë elektorale.

z. Enver Berisha, drejtor I urbanizimit: Që të jemi I saktë, qeveria ka investuar 30 mijë euro aty.

z. Tunë Dedaj: Vetëm dëshiroj që të ju informoj se Çerdhja është e ndërtuar në fshatin Deiq dhe është vendi shumë I mirë. Është shumë gabim që nuk ka përfunduar deri me tani. Ka mbet qysh më keq. Ka pasur vërshime por nuk do të ketë më sepse Drini është rregulluar. Kërkoj nga drejtori I arsimit edhe nga Zafer Gashi pasi e kanë qeverinë që të angazhohen e të përfundoj ajo çerdhe.

z. Ndrec Zefaj: Përshëndetje të gjithëve. Sigurisht se sot po diskutojmë dhe japim propozime konkrete për këtë draft kornizë. Mendoj se komuna e Klinës në tre vitet e ardhshme duhet të investohet në këto projekte: Uji I pijes- u tha se është investuar nga Komuna e nga Qeveria , nuk po më pëlqen ky debat , për këtë çështje kaq jetike do të duhej të ishim bashkë që komuna e Klinës të bëhet me ujë të pijshëm më në fund. Vitin e kaluar kam dhënë një propozim që të merret uji I pijshëm nga Komuna e Istogut por s' di sa është bërë përpjekje. Pa pëlqimin e ministrisë së linjës nuk mund të marrim ujin më ka thënë kryetari. Ftoj ekzekutivin që të merr përgjegjësinë dhe të bisedoj me ministrinë e linjës që të futet në bisedime për marrjen e ujit të pijshëm nga Istogu dhe të furnizohet ajo pjesë e Klinës me ujë të pijshëm të paktën. Pastaj, rritja e cilësisë në arsim dhe shërbime shëndetësore. Duhet të ketë barazi në konkurse dhe meritokraci. Çerdhet publike edhe vitin e kaluar e kam ngritur shqetësimin e çerdhes në fshatin Deiq. Kemi folur shumë për atë çerdhe, po flasim për një çerdhe që nuk kemi bërë asgjë askush. Kërkesë

e jashtëzakonshme qytetarët për çerdhe publike kanë sepse nuk po kanë ku të lë dërgojnë fëmijët. Pastaj tek sektori l bujqësisë propozoj që përkrahja për prodhimin e qumështit të bëhet domosdo 3 cent për litër. Pika e fundit- kultura dhe rinia; pak kemi bërë si komunë, propozoj që të krijohet një qendër multifunkionale që do të shërbej edhe për personat me nevoja të veçanta.

z. Qemajl Sejdiu, drejtor l DKA; Parafolësi tha se nuk kemi bërë asgjë për atë çerdhe por që nuk qëndron. Dy herë kemi pasur shkëmbim të emailit dhe me insistimin tim është intervenuar dhe është vendosur çatia. Nëse ministria nuk ka interes ta përfundoj atë çerdhe është mirë të na tregoj neve si komunë do ta përfundonim. Edhe tek lagja "Arbëria" Na është pamundësuar shkaku l pronës. Ne nuk mund të shpallim në prokurim projektin që e ka nisur ministria e arsimit. Sa herë na është dhënë mundësia në bazë të përgjegjësisë së komunës kemi bërë sa kemi mundur. Drejtorja e arsimit e ka kryer punën e vet nuk kemi pasur çfarë të bëjmë më shumë.

z. Zef Ndrecaj: Unë po nisem nga fakti që deri sot nuk ka pasur rezultate. Pyetje; çerdhja e re sa ka kapacitete?

z. Qemajl Sejdiu, drejtor l DKA: Çerdhja e re ka kapacitet deri në 150 fëmijë. Unë të dëgjova me vëmendje por kur është projekt l dikujt tjetër ne nuk kemi përgjegjësi. Jemi marrë me atë çerdhe por nuk ka pasur rezultate nga ministria.

Znj. Marqe Selmanaj, nënkryetare e komunës: Sa l përket kopshteve , komuna e jonë e mbështet edhe një kopsht publiko privat në Zllakuqan ku komuna l paguan të gjitha shpenzimet e komunalive. Sa l përket kulturës, jemi komuna që ka më së shumti aktivitete kulturore, këtë jua garantoj. Shumë mirë që l potenconi këto çështje gjithsesi.

z. Driton Bardheci, drejtor i DKRS: Tek pjesa e investimeve tek qendra rinore, ne kemi kohë që kërkojmë nga niveli qendror se është projekt l tyre por si komune bojkotohem nga niveli qendror. Çështja e pronës ku është nisur qendra rinore është në gjykatë.

Kryesuesi tha se me këto që u thanë dhe u propozuan të plotësohen në kornizë edhe pse shumica janë veçse në kornizën në fjalë. Prej 2008 nuk ka ujë dhe që 10 vjet është nisur çerdhja në Deiq, veç për këto dy çështje nuk ka seriozitet nëse do të flisja si qytetar l komunës së Klinës.

Me 2 kundër, 6 abstenim dhe 13 për U MIRATUA Draft korniza buxhetore për vitin 2025-2028

Pika 6 e rendit të Ditës: Shqyrtimi l propozim vendimit të DKA për ndarjen e bursave, themelimin e komisionit për ndarjen e bursave.

z. Qemajl Sjedi, drejtor l DKA: Prej vitit 2022 kemi pasur ndarje të bursave për studentët tanë dhe çdo vit kemi rritur numrin e bursave. Vitin e kaluar kemi pasur 80 bursa ndërsa këtë vit propozoj që të ndahen 100 bursa ku çdo bursë do ta ketë vlerën 600 euro. Ju lutem që ta përkrahni këtë propozim.

Çelësi për formimin e komisionit: 2 ekzekutivi , 2 nga kuvendi dhe 1 nga shoqëria civile.

z. Arben Limanaj: Përshëndetje. Ne si grup e mbështesim këtë propozim. Ne gjithashtu propozojmë që dy anëtarë nga kuvendi të jenë nga opozita dhe nga këta dy anëtarë një të jetë nga grupi ynë l LDK-së.

z. Esat Raci: {Pajtohem plotësisht me propozimin e drejtorit të arsimit. Do të dëshiroja që shumica e bursës të jetë më e madhe por mundësitë buxhetore janë të tilla. Për propozimin e Arbenit jam dakord.

z. Valmir Bacaj: Ne si grup kuvendar e përkrahim propozimin e drejtorit të arsimit. E përkrahim propozimin që vlera e bursës të jetë 50 euro sipas propozimit. Sa i përket anëtarëve të kuvendit për komision, është rregullorja që e përcakton. Një anëtar të jetë nga opozita dhe një nga pozita siç ka qenë deri me tani.

z. Zafer Gashi: Kërkesat tona si subjekt për rritjen e vlerës së bursave ka qenë edhe më herët dhe natyrisht që e përkrahim këtë propozim. Është mirë me qenë që dy anëtarët nga kuvendi të jenë nga opozita.

z. Arben Limanaj: Komisioni nuk mund të i ik rregullores dhe kriterëve. Në pajtueshmëri edhe me partinë në pushtet mirë do të ishte të mbështetet propozimi im.

z. Valmir Bacaj: Ne pajtohemi sido që të vendoset.

z. Adnan Beqiri: Përsëndetja. Unë e shoh të arsyeshme që një anëtarë të jetë nga pozita dhe një nga opozita s'di pse insiston opozita që ti ketë të dy anëtarët.

z. Esat Raci: A ka mundësi që përfitues të jenë edhe studentët që studiojnë në Shqipëri dhe Maqedoninë e veriut?

z. Qemajl Sjediu, drejtor i DKA: Ministria e arsimit ndanë bursa edhe për studentët jashtë vendit por për me ju dhënë ne bursa atyre studentëve duhet të ndryshohet rregullorja.

Me 23 vota për, asnjë kundër dhe asnjë abstenim u MIRATUA numri 100 bursa dhe vlera e bursës 50 euro.

Për komisionin u propozuan:

1. Kushtrim Haliti
2. Blerina Gashi
3. Shoqëria civile- Vitore Zefaj
4. Astrit Muhaxheri
5. Nikson Dakaj

Me 23 vota për, asnjë kundër dhe asnjë abstenim U MIRATUA komisioni për ndarjen e bursave.

Pika 7 e Rendit të Ditës: Rishqyrtim i vendimit i miratuar me datë 25 prill 2025

Kryesuesi tha se është vendim i marrë nga kuvendi për ndarjen e shumës prej 11 mijë euro për policinë e Kosovës në Klinë, por është kthyer nga ministria e linjës që nuk kemi të drejtë. Ky vendim duhet të anulohet, tha kryesuesi duke shprehë keqardhje që nuk ka kaluar në ministrinë e linjës për ligjshmërinë e vendimit.

Me 20 vota për, asnjë kundër dhe asnjë abstenim U ANULUA vendimi

Pika 8 e Rendit të Ditës: Raportimi i kryetarit të komunës për rrjedhat e qeverisë në 6-të mujorin e parë të vitit 2025.

Në mungesë të kryetarit të komunës, z. Zenun Elezaj, raportin e lexon nënkryetarja e komunës, znj. Marqe Selmanaj.

Znj. Marqe Selmanaj, nënkryetare e komunës: Të nderuar pjesëmarrës/e, zonja dhe zotërinj. Në emër të Kryetarit të Komunës, kemi kënaqësinë t'ju paraqesim raportin e gjashtëmujorit të parë të punës së ekzekutivit të komunës për vitin 2025. Ky raport përmbledh një pasqyrë të detajuar të punës së ekzekutivit, duke përfshirë të arriturat, projektet kryesore dhe aktivitetet që janë realizuar në funksion të përmirësimit të mirëqenies së qytetarëve tanë. Kjo periudhë kohore ka qenë një e rëndësishme në rrugëtimin tonë zhvillimor komunal – gjysme viti në të cilin janë realizuar një sërë projektesh të nevojshme dhe të dobishme në fushën e infrastrukturës, arsimit, shëndetësisë, shërbimeve publike dhe mirëqenies sociale. Të gjitha këto janë zhvilluar në përputhje me Planin e Punës të komunës, Strategjinë Zhvillimore Komunale dhe kornizën ligjore në fuqi. Me synim rritjen e transparencës, përmirësimit të llogaridhënies dhe nxitjen e pjesëmarrjes qytetare, gjatë vitit 2025 janë mbajtur takime publike me qytetarët, në harmoni me dispozitat e Ligjit për qeverisje Lokale. Këto takime kanë ofruar hapësirë për komunikim të drejtpërdrejtë me qytetarët dhe kanë shërbyer si bazë për orientimin më të saktë të prioritetëve komunalë. Gjithashtu, gjatë kësaj kohe janë organizuar dëgjime buxhetore për Kornizën Afatmesme të Buxhetit (KAB) dhe për projektbuxhetin e komunës për vitin 2026. Pjesëmarrja e gjerë në këto dëgjime ka kontribuar në hartimin e një buxheti të balancuar dhe gjithëpërfshirës, i cili reflekton nevojat dhe kërkesat reale të qytetarëve të komunës sonë. Të gjitha këto arritje janë rezultat i përkushtimit institucional, bashkëpunimit të ngushtë me qytetarët dhe mbështetjes së vazhdueshme të stafit të administratës komunale me kryetarin e komunës në krye. Falënderojmë të gjithë qytetarët për angazhimin e tyre aktiv, idetë dhe sugjerimet që kanë dhënë përgjatë këtij gjashtëmujori. Në emër të Kryetarit të Komunës, ritheksojmë zotimin për të vazhduar punën me përkushtim, transparencë dhe përgjegjësi, duke i qëndruar gjithmonë afër nevojave të qytetarëve dhe synimeve tona të përbashkëta për një komunë më të zhvilluar, më funksionale dhe më gjithëpërfshirëse.

Pika 9 e Rendit të Ditës: Pyetje dhe Përgjigje

Znj. Arta Pantina: Përshëndetje. Dëshiroi të bëjë një kërkesë që të vendosen kabina, në fshatra , qytet etj.

Znj. Besiana Gashi: Përshëndetje. Kam një kërkesë të cilën e kam përcjellë. Kërkoj që të shtrohet një pjesë e asfaltit në hyrje të shkollës në Grabanicë si dhe vendosjen e policëve të shtrirë në atë hapësirë. Pyetja tjetër për drejtorin e financave: Kur do të filloni që të bëni pagesat për anëtarët e Komitetit për komunitete.

Kryesuesi tha se dje e kanë pasur takimin me kolegjiunin e kryesuesve të kuvendeve. Këtë telashe e kanë edhe kuvendet e tjera edhe pse kemi pasur një marrëveshje që të nisin me pagesat por nuk kanë mbajtur fjalën e dhënë. Nuk na lëshojnë as shkresë shpjeguese zyrtare.

z. Esat Raci: Kam disa pyetje të shkurtra për DKRS. Shoqatat e dala nga lufta, klubi i boksit "Dukagjini" kanë bërë kërkesë tek kryetari i komunës për të qenë pjesëmarrës në FF" I këndojmë Lirisë". Pyetja tjetër: Revista "Lyra" nuk është botuar edhe pse mjetet janë ndarë. Dhe a ka pasur shkelje të rregullores së festivalit për ndarje të çmimeve.

z. Driton Bardheci, drejtor i DKRS: Pyetja është me tendencë, merrni informacione të sakta. Klubi i boksit "Dukagjini" është subvencionuar si OJQ kur kanë aplikuar. Kërkesa për zyrën e kryetarit ka qenë që përveç subvencionimeve që i janë ndarë, kam raporte korrekte me përfaqësuesit të klubit, nuk është mirë me krijuar situatë të pa qenë... Për revistën "Lyra" unë e diji që është botuar në ditën e tretë të festivalit. Rregullorja nuk e diji se ku është shkelur. Nuk ka pasur shkelje të rregullores.

z. Esat Raci: Pyetja ka qenë se a është shkelur rregullorja. Me 24 . 10. 2024 nga tre organizatat e dala nga lufta, kërkesë për kryetarin e komunës për pjesëmarrje në festival, përgjigje nuk aknë marrë.

z. Fadil Gashi, kryesues tha se ka me ardhur një raport për festivalin në seancë të korrikut që do ta shqyrtojmë.

z. Qemajl Sejdiu. Drejtor I DKA: Besianës I mbeta borgj. Komiteti për komunitete ka bërë punë të mira me vizita etj. do të doja që edhe komitetet e tjera të kryejnë punë. Për pagesat, përmbarimi na I ka marrë 25 mijë euro prandaj kemi mbetur keq me pagesat.

Znj. Ilirjana Toplanaj: Përshëndetje të gjithëve. Çka është bërë me shtegun e ecjeve në Pogragjë?

z. Enver Berisha, drejtor I Urbanizimit: Projekti në fjalë është I bashkuar me projektin e Jashanicës dhe janë duke u bërë gati që të vendosen në një projekt.

Procesmbajtës

Monika Palushaj



Kryesuesi

Fadil Gashi

